

Q Ë N D R I M P U B L I K

Deputetët dhe Kuvendi i Shqipërisë duhet të përmbushin përgjegjësitë e tyre për nisjen e punës dhe realizimin e një Reforme të vërtetë Zgjedhore, të mbështetur në parimet e transparencës dhe gjithëpërfshirjes

Në seancën e së enjtes datë 9 qershor 2022, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi përbërjen¹ e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore prej 18 anëtarësh, duke plotësuar kështu vendimin e ngritjes së këtij Komisioni² të miratuar më datë 10 shkurt 2022, me një afat veprimtarie gjashtë mujor, deri më datë 10 gusht 2022.

KRIIK e vlerëson tejet pozitivisht plotësimin e detyrimit të Kuvendit për të bërë funksional Komisionin e Posaçëm dhe nisur Reformën Zgjedhore, sikurse tërë aktorët politikë kanë shprehur nevojën dhe gatishmërinë.

Me këtë vendim i hapet rruga reformimit të kuadrit ligjor për zgjedhjet, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR dhe të aktorëve vendas³, me zbatimin më të parë në zgjedhjet vendore të majit 2023, por edhe për amendime të tjera me rëndësi me zbatim në zgjedhjet parlamentare të 2025-ës apo edhe më vonë, në përmbushje të premtimeve të bëra dhe angazhimeve të marra nga forcat politike parlamentare.

Këto angazhime dhe deklarime publike kanë theksuar nisjen e menjëhershme të punës sapo Komisioni i Posaçëm Parlamentar të konstituohet, për më tepër që nga zgjedhjet e ardhshme lokale na ndajnë vetëm 10 muaj.

Në ndryshim me këtë qëndrim dhe në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, e cila parashikon mbledhjen e Komisionit brenda dy ditësh⁴, afat ky që përfundon ditën e sotme, **deri në këto momente nuk ka asnjë njoftim për mbledhjen e tij**, as në media dhe as në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë. Madje kjo e fundit ende figuron e papërditësuar dhe e paplotë për tu informuar.

KRIIK ngre shqetësimin e tij se kjo qasje ndaj këtij procesi shumë të rëndësishëm, nuk është aspak serioze qoftë nga deputetët anëtarë të Komisionit, qoftë nga partitë dhe grupet parlamentare përbërëse, por edhe nga vetë Kuvendi i Shqipërisë.

¹ [Projektvendim Nr. ___/2022 "Për një ndryshim në vendimin e kuvendit nr 12/2022 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore" dhe miratimi i përbërjes të tij"](#). (Theksohet se faqja e internetit e Kuvendit është ende e papërditësuar me variantin final të miratuar në seancën e djeshme).

² [Vendimi Nr. 12/2022 datë 10.02.2022](#) i Kuvendit të Shqipërisë "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore".

³ "Komisioni ka për detyrë hartimin e ndryshimeve legjislativë për reformën zgjedhore, në veçanti trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe për zgjedhjet e mëparshme të patrajuara, rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet, të partive politike parlamentare dhe organizatave jofitimprurëse", pika II e Vendimit nr. 12/2022 të Kuvendit të Shqipërisë.

⁴ "Brenda 2 ditëve nga përcaktimi në seancë plenare i programit të punës dhe i kalendarit të punimeve të Kuvendit, komisioni mblidhet për miratimin e programit të punës dhe kalendarit të punimeve të tij. Programi i punës dhe kalendarit i punimeve të komisionit duhet të garantojnë zbatimin në kohë të çështjeve që janë parashikuar për shqyrtim në seancë plenare.". [Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë](#), e përditësuar, neni 38 "Shqyrtimi i çështjeve", pika 1.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka ndjekur në vazhdimësi dhe në mënyrë të pandërprerë, veçanërisht pas reformës zgjedhore të vitit 2012, problematikat e integritetit të votës dhe të zgjedhjeve, si një proces kompleks ku përfshihet sjellja, ligjzbatimi dhe funksionimi i tërë ngrehinës institucionale dhe politike në raport me detyrimin kushtetues për respektimin dhe garantimin e vullnetit të lirë dhe të pacënuar të votuesit dhe popullit shqiptar.

Nën këtë përvojë dhe analizë, KRIIK shpreh shqetësimin e tij **për gjendjen serioze të mospërbushjes së përgjegjësive dhe detyrimeve të Parlamentit të Shqipërisë, deputetëve dhe forcave politike që ata përfaqësojnë, në kundërshtim me frymën dhe gërmën e Kushtetutës**, e cila i jep deputetëve të saj dhe Parlamentit të Shqipërisë pushtetin dhe vullnetin e deleguar të sovranit, për ndërtimin dhe mirëfunksionimin e një shteti ligjor, të së drejtës dhe të një demokracie funksionale që duhet të bazohet në parimet e gjithëpërfshirjes, dialogut, transparencës e llogaridhënies, me fokus dhe në interes vetëm të popullit.

Marrëveshja e 5 qershorit 2020, pas krizës së tejzgjatur 2017 – 2020, me kulmimin “apokaliptik” të 2019-ës, **duhet të shërbejë si bazë për një qasje totalisht të re të të menduarit dhe vepruarit të klasës politike, veçanërisht të deputetëve dhe partive të tyre parlamentare, jashtë praktikave të përjashtimit, arrogancës së shumicës⁵ dhe fiktivitetit të proceseve dhe reformave të ndërmarra.**

Vonesa prej 4 muajsh në plotësimin e përbërjes së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, ngecja e Komisionit Hetimor Parlamentar mbi Zgjedhjet e vitit 2021, apo së fundi dështimi i përbushjes së angazhimeve dhe përgjegjësive për procesin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës, në kundërshtim me frymën e Kushtetutës, evidenton **një qasje shqetësuese se angazhimi serioz dhe i vërtetë, për të adresuar problematikat madhore të integritetit të zgjedhjeve, do të jetë i cunguar apo do të mungojë përmbajtësisht.**

Përgjegjësi që i faturohet në rradhë të parë mazhorancës qeverisëse, e cila me përqëndrimin në duart e saj të të gjithë pushteteve duhet të reflektojë dhe përcjellë më shumë se kurrë maturi, duke filluar së pari t’i japë frymëmarje dhe hapësirën e nevojshme, sipas Kushtetutës, funksionimit të duhur të Kuvendit të Shqipërisë, ku duhet të mbizotërojë respekti i ndërsjellë ndaj çdo deputeti, dialogu dhe ndërveprimi i sinqertë e vizionar në emër të interesit më të mirë të qytetarëve dhe të së ardhmes demokratike të vendit.

Në këtë kontekst dhe të një polarizimi të skajshëm e të vazhdueshëm politik, KRIIK tërheq vëmendjen për nevojën që **aktiviteti i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore të udhëhiqet nga parimet e transparencës dhe gjithëpërfshirjes.**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

⁵ “Demokracia e udhëhequr nga sundimi i ligjit nuk ka të bëjë vetëm me respektimin formal të procedurave që i mundësojnë shumicës të udhëheqë, por edhe me diskutimet dhe shkëmbimin kuptimplotë të pikëpamjeve ndërmjet shumicës dhe opozitës. Komisioni i Venecias dhe ODIHR i nxisin forcat politike shqiptare – si brenda, ashtu edhe jashtë parlamentit – që të sigurojnë funksionimin normal demokratik të institucioneve në vend në interes të popullit shqiptar.”, pika 34 e Opinionit Nr. 1006/2020, [CDL-AD\(2020\)036. Opinion i përbashkët “Mbi ndryshimet në kushtetutë më 30 korrik 2020 dhe në Kodin Zgjedhor më 5 tetor 2020”, datë 11.12.2020](#), Komisioni Europian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) dhe Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSCE/ODIHR).

Praktika e proceseve të mbyllura, me mungesë të thellë të transparencës dhe përfshirjes domethënëse të aktorëve vendorë, si dhe e **dakordësisë së ngushtë në momentet e fundit, duhet të marrë fund.**

Funksionimi dhe zhvillimi i vërtetë i proceseve demokratike, si dhe legjitimitimi i plotë e i vërtetë i Institucioneve të zgjedhura me votën e lirë e të pandikuar të shtetasve shqiptarë, nuk mund të vazhdojë të mbetet peng i interesave të ngushta të partive politike.

KRIIK në vazhden e aktivitetit të tij advokues, **ka shprehur konsideratën e tij për lidhshirësinë e partive kryesore parlamentare për dimensionin e zgjeruar të bashkëpunimit me shoqërinë civile** e veçanërisht me KRIIK, si dhe për pjesëmarrjen dhe angazhimet e marra në aktivitetet e zhvilluara⁶. Por është e **domosdoshme që këto angazhimeve të mbahen dhe përcillen përmbajtësisht në jetën institucionale e politike të vendit.**

KRIIK i bën thirrje dy BashkëKryetarëve, deputetëve anëtarë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore apo edhe Kreut të Kuvendit **që të mbledhin sa më parë Komisionin, duke dakordësuar dhe miratuar sa më shpejt planin e punës dhe një rregullore të posaçme të tij**, për të siguruar gjithëpërfshirjen dhe pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë jashtëparlamentarë, si dhe procedurat e ndërveprimit me ta.

Është e nevojshme që hartimi i **Planit të Punës të pasqyrojë, së pari, vullnetin politik për gamën dhe thellësinë e ndërhyrjeve** që do të ndërmerren.

Veçanërisht është e domosdoshme të qartësohet urgjentisht nëse Reforma Administrativo-territoriale që do të kryhet⁷, do të ketë apo jo qëllimin për tu aplikuar në zgjedhjet vendore të pranverës 2023.

Në këtë proces, pavarësisht numrit të konsiderueshëm të çështjeve që kërkojnë rregullim, duhet mbajtur në vëmendje koha e kufizuar në dispozicion, si dhe Kodi i Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore për kufizimin e ndryshimeve ligjore madhore në periudhën e më pak se një viti përpara ditës së zgjedhjeve.

Lidhur me këtë kufizim, KRIIK i **sugjeron Komisionit që të mbyllë amendimet ligjore minore dhe specifike në raport vetëm me mirëfunksionimin e zgjedhjeve të ardhshme vendore brenda muajit Korrik 2022**, ndërkohë që në sesionin e ardhshëm parlamentar të fillojë e të trajtojë tërë rregullimet e tjera për tu aplikuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 apo edhe më pas, si dhe hartimin e ligjit të posaçëm për financimin e partive politike e fushatave zgjedhore, ligjin për referendimet, si dhe një ligj të ri për partitë politike.

⁶ Domosdoshmëria për Dialog, Transparencë dhe Gjithëpërfshirje, si dhe për një konkretizim sa më të shpejtë të angazhimeve dhe vënies në funksionim të Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, ishte një nga temat bazë edhe të një prej eventeve të fundit të KRIIK, Konferencës Kombëtare “[Shoqëria Civile dhe Politike: për një dialog dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse](#)”, të organizuar në 16 shkurt 2022.

⁷ [Projektvendim Nr. /2022 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 13/2022 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë, si dhe miratimi i përbërjes të tij”](#), datë 09.06.2022.

[Vendimi Nr. 13/2022, datë 10.02.2022](#) i Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë”.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Ndërsa përsa i përket amendimeve lidhur me zgjedhjet e ardhshme lokale, bazuar në vëzhgimin e kryer përgjatë periudhës 2018-2022, në kuadër të monitorimit të zgjedhjeve parlamentare⁸ dhe vendore⁹ të fundit, **KRIIK i sugjeron dhe i kërkon Komisionit të Posaçëm Parlamentar të përqëndrohet, por jo të kufizohet, në çështjet e mëposhtme të konsideruara si më të rëndësishmet në kontekstin e ndodhur:**

1. ***Reflektimi nëpërmjet amendimeve të duhura ligjore në përputhje me dispozitat e Vendimit nr. 28 datë 30.06.2021 të Gjykatës Kushtetuese¹⁰***, e cila ka vendosur shfuqizimin e pikës 3 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor, si të papajtuashëm me Kushtetutën.

Në vlerësimin e Gjykatës, në përcaktimin e herësit nuk duhet të vendosen kufizime në një masë më të madhe se sa është e nevojshme për të arritur objektivat, në respektim të së drejtës për të zgjedhur dhe parimit të barazisë së votës. Për rrjedhojë, Gjykata ka vlerësuar se parashikimi i herësit, lidhur me vlerën e tij numerike, i përcaktuar në pikën 3 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor, si një ndër kriteret që ndikon në shpërndarjen e mandateve, çënon të drejtën për të zgjedhur, pasi nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit.

Ky nen dhe kjo mënyrë shpërndarje e mandateve për listat shumëëmërore në zgjedhjet për Kuvend, duhet të përdoret edhe për shpërndarjen e mandatave të anëtarëve të Këshillit Bashkiak për listat shumëëmërore të partive apo koalicioneve.

2. ***Rregullimi i transparencës dhe mbikëqyrjes së financimit të subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore.*** Mungesa e transparencës dhe mbikëqyrja jo-efektive mbi financat e subjekteve zgjedhore është një nga problematikat madhore të zgjedhjeve në vend dhe që kërkon ndërhyrje urgjente dhe rrënjësore.

Pavarësisht se problematika është goxha më e gjerë për tu trajtuar, është e nevojshme që Komisioni të adresojë, së paku, tërë mangësitë e nevojat e hasura për rregullime minore, si dhe ngërçet e krijuara gjatë aplikimit të dispozitave ekzistuese ligjore në zgjedhjet e mëparshme.

Konsiderohet e nevojshme gjithashtu që të specifikohet eksplicitisht se veprimtaria financiare e partive politike nuk është ekskluzivitet vetëm i funksionit kontrollues të KQZ-së, por edhe i institucioneve të tjera të ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e veprimtarive financiare e ekonomike.

Gjithashtu, specifikimi më vete i shpenzimeve të kryera me fonde publike, në raportimet e dorëzuara, në gjykimin e KRIIK, do të siguronte më shumë objektivitet nga subjektet zgjedhore, pasi do të lehtësonte mundësimin e kontrollit të kryqëzuar edhe prej institucioneve të tjera shtetërore, si dhe do të nxiste dhe lehtësonte akoma më shumë barrën e KQZ-së në përmbushje të detyrimeve ligjore të parashikuara dhe marrjen e sanksioneve përkatëse.

3. ***Adresimin e plotë të fenomenit të keqpërdorimit të burimeve shtetërore dhe ofiqit publik për avantazh elektoral gjatë fushatës zgjedhore dhe bërjen efektive të mekanizmit të parashikuar duke adresuar ngërçet e vërejtura apo të krijuara***

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

⁸ KRIIK Albania, [Raport Përfundimtar Vëzhgimi "Mbi procesin e Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit 2021"](#), Shtator 2020 – Janar 2022.

⁹ KRIIK Albania, [Raport Përfundimtar, "Sjellja ligjore dhe institucionale e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019"](#), Nëntor 2018 – Shkurt 2020.

¹⁰ [Vendimi nr. 28 datë 30.06.2021](#) i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë.

gjatë aplikimit dhe praktikës së ndjekur prej KQZ-së dhe aktorëve të tjerë institucionalë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021.

Pavarësisht amendimeve ligjore të vitit 2020 që synuan të adresojnë këtë problematikë, përdorimi i burimeve shtetërore dhe ofiqit publik për avantazh elektoral vijoi të jetë një problematikë madhore, madje u përkeqësua në zgjedhjet e fundit parlamentare.

Nga ana tjetër, mekanizmi kontrollues i parashikuar nga Kodi Zgjedhor për adresimin e problemit, nuk arriti të parandalonte përdorimin e burimeve publike, duke u kthyer në një mekanizëm burokratik dhe jo eficient.

Për hir të specifikave të zgjedhjeve të ardhshme vendore, ku maxhoranca aktuale parlamentare kontrollon thuajse të gjitha bashkitë e vendit, KRIIK vlerëson se rreziku i përdorimit të burimeve shtetërore është akoma më i madh, duke e vendosur dhe dhënë maxhorancës një avantazh të theksuar.

Jo vetëm kaq, por vazhdimësia dhe konsolidimi i një praktike të tillë negative do të vazhdojë të sjellë pasoja madhore në sistemin demokratik në vend, në kundërshtim me perceptimin dhe sjelljen, që duhet të kenë dhe manifestojnë institucionet shtetërore e punonjësit e tyre.

4. *Monitorimi i medias audiovizive nga ana e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), vuan nga mungesa e efektivitetit në një numër elementësh, por si më e prioritare e që duhet plotësuar në kuadrin ligjor, KRIIK vlerëson se janë:*

- *mungesa e monitorimit sistematik të të gjithë Ofruesve të Shërbimi Mediatik Audioviziv (OSHMA) në nivelin lokal, si dhe*

- *mungesa e një metodologjie cilësore, e cila të evidentojë jo vetëm minutazhin për subjektet zgjedhore, por edhe tonin/gjuhën e përdorur.*

E para është tejet e rëndësishme, duke qenë se zgjedhjet e ardhshme janë lokale, dhe media audiovizive lokale do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në fushatë.

E dyta është e rëndësishme pasi evidentimi vetëm i minutave të kushtuara një subjekti zgjedhor nga një media, jo vetëm nuk është efektiv, por mund të japë një ide të shtrembëruar. Duke evidentuar tonin e përdorur në materialet audiovizive mundësohet jo vetëm një panoramë më e qartë e mbulimit mediatik, por edhe fakti nëse operatorët audiovizivë ofrojnë një panoramë të balancuar dhe neutrale gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore.

5. Duke qenë se fushatat elektorale po përqëndrohen gjithmonë e më shumë në *mediat sociale, është i nevojshëm rregullimi, parashikimi dhe cilësimi i tyre si media në kuadrin ligjor*, duke patur në konsideratë përfshirjen edhe të rrjeteve sociale.
6. *Parashikimi dhe rregullimi i fushatës nga palët e treta*, veçanërisht asaj në mediat tradicionale dhe mediat sociale. Ndikimi i palëve të treta në fushatë, konsiderohet të jetë më i lartë në zgjedhjet vendore, për shkak të konkurrimit dhe kontaktit më të drejtëpërdrejtë jo vetëm të kandidatëve, por edhe forcave politike, si dhe numrit të madh të tyre në këto lloj zgjedhjesh.

7. *Parashikimi dhe plotësimi i kriterëve të regjistrimit¹¹ të partive politike* duke depozituar vërtetimin e gjykatës nëse subjekti është konform kriterit kushtetues

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

¹¹ [OPINION Mbi Projekt-udhëzimin "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit"](#), dërguar KQZ-së më datë 14.12.2020.

dhe ligjor për kryerjen e zgjedhjeve demokratike e periodike, si dhe zgjedhjen në mënyrë demokratike të forumeve të veta drejtuese, konform parashikimeve të statutit. Gjithashtu detajimin e cv-ve të kandidatëve të këshillave bashkiakë, në raport me informimin e publikut mbi integritetin e tyre dhe angazhimet e tjera që ky kandidat ka patur ose ka.

Në përfundim, **KRIIK sjell në vëmendje të Partive Politike Parlamentare** një çështje të ngritur edhe më parë, sikurse është depolitizimi i Komisioneve Zgjedhore, duke filluar së pari me **depolitizimin e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ)**.

Në gjykimin e KRIIK, kjo pikë, ndonëse e parashikuar në Marrëveshjen Politike të 5 qershorit 2020, për tu realizuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, duhet marrë në konsideratë e shqyrtuar mundësia për aplikimin e saj që në këto zgjedhje, si një formë edhe e **adresimit të problematikës që përmban sistemi i patronazhimit politik dhe nevojës për nisjen e zhbërjes së tij në administratën shtetërore**.

Depolitizimi i këtij niveli administrimi dhe emërimi me short i një numëri më të vogël komisionerësh më të përgjegjshëm dhe përgjegjës për zbatimin e ligjit, do të sigurojë ndër të tjera **një zbatim më të mirë të kuadrit ligjor, si dhe mbikqyrjen e duhur për përmbushjen e detyrimeve ligjore prej tërë aktorëve dhe institucioneve të përfshirë** në ndërtimin dhe ecurinë e procesit zgjedhor. Administrimi tërësor i pushtetit vendor nga mazhoranca në pushtet, është një arsye më shumë për të siguruar sjelljen konform ligjit të këtij pushteti në raport me rolin e rëndësishëm që ai ka në ndërtimin e procesit zgjedhor.

Megjithëse praktikatat më të mira ndërkombëtare sygjerojnë se ndryshimet ligjore për çështje si kjo duhet të realizohen një vit përpara zgjedhjeve, ky është një hap për të cilin vlerësohet se **një vullnet politik i plotë e i dakordësuar mund dhe duhet ta ndërmarrë edhe në kaq kohë, për shkak të kontekstit të gjendur dhe nevojave imediate që paraqiten**.

Tiranë, më 11 Qershor 2022

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania